




PLANI I PUNËS
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICA

GJA.nr.19/23

Datë: 16.01.2023

Plani i punë së Gjykatës Themelore Mitrovicë për vitin 2023 ka për qëllim organizimin dhe koordinimin e punës së Gjykatës, ashtu që në kuadër të dispozitave ligjore në fuqi të kemi një menaxhim sa më efikas të punës së Gjykatës, duke synuar efikasitet në arritjen e zgjidhjeve sa më të shpejta për lëndët të cilat janë në punë në atë mënyrë që të kemi një nivel të knaqshmërisë tek palët, menjanimin e mangësive dhe pengesave gjatë punës të cilat i kemi hasur në të kaluarën po ashtu qasje sa më të lehtë për palët apo personat e interesuar duke pasur parasysh parimin e një gjyqësori të hapur në kuadër të dispozitave ligjore në fuqi.

Përmbledhje e Planit të Punës – Gjykata Themelore Mitrovicë

- Neni 1 – Organizimi i punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë
- Neni 2 – Departamentet dhe divizionet në kuadër të Gjykatës Themelore Mitrovicë
- Neni 3 – Caktimi i gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Mitrovicë
- Neni 4 – Udhëheqësit e departamenteve/divizioneve në kuadër të Gjykatës Themelore Mitrovicë
- Neni 5 – Kryetari i Gjykatës dhe Nënkyetari i Gjykatës
- Neni 6 – Organizimi i punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri
- Neni 7 - Organizimi i punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj
- Neni 8 - Organizimi i punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega në Leposaviq
- Neni 9 - Organizimi i punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega në Zubin Potok
- Neni 10 – Përbërja e trupeve gjyqësore dhe kolegjeve
- Neni 11 – Ndarja e lëndëve
- Neni 12 – Radha e zgjidhjes së lëndëve
- Neni 13 – Përpilimi i aktgjykimeve, publikimi dhe transparenca
- Neni 14 – Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë, vendosja e akteve gjyqësore në sistemin e evidencës penale
- Neni 15 – Dërgimi i lëndëve në gjykatat e tjera sipas shkallshmërisë dhe zbatimi i sistemit SMIL
- Neni 16 – Mbledhjet e kolegjiuemeve të gjyqtarëve dhe stafit administrative
- Neni 17 – Organizimi i punës së administratës së Gjykatës Themelore Mitrovicë dhe degët e saj
- Neni 18 – Ndryshimet dhe plotësimet e Planit Vjetor
- Neni 19 – Zbatimi i planit

Duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat dhe nenin 11 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Nënkyetari i Gjykatës Themelore Mitrovicë Bekim Veliqi, pas marrjes së mendimit të gjyqtarëve të kësaj Gjykate, në kolegjumit e mbajtur më datë 13.01.2023, me dt.16.01.2023, përcakton:

PLANIN VJETOR TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE MITROVICË PËR VITIN 2023

NENI 1

ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE MITROVICË

1. Organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore Mitrovicë, do ta udhëheqë Nënkyetari i Gjykatës Bekim Veliqi (në mungesën aktuale të Kryetarit të Gjykatës).

2. Nënkyetar i Gjykatës është Gjyqtari Bekim Veliqi .

NENI 2

DEPARTAMENTET DHE DIVIZIONET NË KUADËR TË GJYKATËS

1. Për kryerjen e funksioneve gjyqësore në Gjykatën Themelore Mitrovicë, do të funksionojnë këto departamente :

1.1 Departamenti për Krime të Rënda;

1.2 Departamenti i Përgjithshëm;

1.3 Departamenti për të Mitur.

2. Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm, do të funksionojnë:

2.1 Divizioni Penal;

2.2 Divizioni Civil;

2.3 Divizioni për Kundërvajtje.

2. Në çdo departament dhe divizion do të caktohet nga një gjyqtar si udhëheqës i departamentit/divizionit përkatës.

NENI 3

CAKTIMI I GJYQTARËVE

1. Në Gjykatën Themelore Mitrovicë, duke përfshirë edhe degët e saj, monetalisht do të punojnë njëzet e tetë (28) gjyqtarë (ndërsa sipas organogramit të miratuar nga KGJK-ja duhet të jenë 61) ku të gjithë janë të sistemuar në departamente, degë dhe divizione si vijon:

2. Në Gjykatën Themelore Mitrovicë do të punojnë këta gjyqtarë të cilët janë të ndarë në departamente dhe divizione si në vijim:

2.1 Në Departamentin për Krime të Rënda do të punojnë gjashtë (6) gjyqtarë:

Ali Kutllovci

Avni Mehmeti

Bekim Veliqi
Mentor Hajraj
Gëzim Ademi
Rahman Beqiri

2.2 Në Departamentin për të Mitur do të punoj një (1) gjyqtar;
Pranvera Ademi

2.3 Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal do të punojnë dy (2) gjyqtarë:
Xhemajl Jusufi
Benita Berisha

2.4 Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil do të punojnë shtatë (7) gjyqtarë:
Skender Shala,
Blerim Halimi
Blerim Istrefi
Erolinda Uka Sadiku
Genc Hasani
Dardani Ismajli
Fuad Haliti

2.5 Gjyqtarët Erolinda Uka Sadiku, Dardane Ismajli, Genc Hasani dhe Fuad Haliti pritet që të fillojnë në aspektin praktik të trajnimit që nga datë 01.02.2023 pasi që të njëjtit janë në arsimimin e vazhdueshëm pranë Akademisë së Drejtësisë.

2.6 Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjes do të punojnë dy (2) gjyqtarë:
Nuriye Shala e cila caktohet të punoj edhe në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjes për Degët e Gjykatës në Vushtrri, Skenderaj, Zubin Potok dhe Leposaviq.
Fluriye Sylja e cila caktohet të punoj edhe në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjes për Degët e Gjykatës në Vushtrri, Skenderaj, Zubin Potok dhe Leposaviq.

3. Gjyqtari Ali Kutllovci, i cili paraprakisht ka kryer edhe punë të natyrës së ndihmës juridike ndërkombëtare siç është cekur edhe në planin vjetor të punës për vitin 2022, vazhdon t'i kryej këto punë edhe gjatë vitit 2023, me mundësinë edhe të angazhimit të ndonjë gjyqtari tjetër në këtë lëmi.

NENI 4

UDHËHEQËSIT E DEPARTAMENTEVE/DIVIZIONEVE NË KUADËR TË GJYKATËS THEMELORE MITROVICË

1. Udhëheqësit e divizioneve-departamenteve do t'i raportojnë së paku një herë në tre muaj për punën e divizioneve-departamenteve përkatëse Kryetarit të Gjykatës.
2. Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit të përgjithshëm do të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të divizioneve.
3. Kryetari i Gjykatës mund të kërkojë nga udhëheqësit e departamenteve/divizioneve që të paraqesin raporte mujore ose raporte për ecurinë e lëndëve të natyrave të veçanta.

4. Për udhëheqës të departamenteve dhe të divizioneve pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë janë caktuar:

Gjyqtari Mentor Hajraj Udhëheqës i Departamentit për Krime të Rënda;

Gjyqtari Xhemajl Jusufi Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Penal;

Gjyqtari Skender Shala Udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Civil;

Gjyqtarja Pranvera Ademi Udhëheqëse e Departamentit për Mitur;

Gjyqtarja Flurije Syla Udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje.

NENI 5

KRYETARI I GJYKATËS DHE NËNKRYETARI I GJYKATËS

1. Kryetari i Gjykatës i ushtron kompetencat e përcaktuara me ligj dhe rregullore në fuqi, mund të angazhohet në trupa gjykues, ekzekutimin e vendimeve, pezullimin e ekzekutimit të dënimeve si dhe në të gjitha çështjet e tjera të përcaktuara me ligj dhe rregulloret në fuqi.

2. Kryetari i Gjykatës e zëvendëson gjyqtarin e procedurës paraprake në rastet kur nuk mund të veproj për shkak të përjashtimit, sëmundjes etj.

3. Nënkyetari i Gjykatës i ushtron kompetencat e tij në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, po ashtu në rast të mungesës për rastet të caktuar specifike të Kryetarit të Gjykatës i njëjti ushtron detyrat e Kryetarit të Gjykatës.

4. Nënkyetari i Gjykatës Bekim Veliqi është i caktuar Gjyqtar pranë Departamentit për Krime të Rënda.

NENI 6

ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI

1. Në kuadër të Degës së Gjykatës në Vushtrri do të funksionojë Departamenti i Përgjithshëm me divizionin penal, civil dhe divizioni për kundërvajtje me gjyqtarët aktual si në vijim:

1.1 Divizioni Penal;

Gjyqtari Agron Maxhuni

Gjyqtari Ferki Xhaferi

1.2 Udhëheqës i Divizionit Penal do të jetë Gjyqtari Agron Maxhuni

1.3. Divizioni Civil:

Gjyqtari Izet Gërguri

Gjyqtari Naim Rekaliu

Gjyqtari Jeton Zymeri

Gjyqtarja Valbone Fejza e cila pritet që të filloj në aspektin praktik të trajnimit që nga datë 01.02.2023 pasi që e njëjta është në arsimimin e vazhdueshëm pranë Akademisë së Drejtësisë.

1.4 Udhëheqës i Divizionit Civil do të jetë Gjyqtari Izet Gërguri.

1.5 Ashtu edhe siç është përcaktuar në nenin 2 par.2 nën par.2.5 të këtij Plani, në Divizionin për Kundërvajtje janë përcaktuar që Gjyqtarja Nuriye Shala dhe Gjyqtarja Flurije Sylaj t'i kryejnë edhe lëndët e Degës së Gjykatës në Vushtrri me qenë se nuk ka gjyqtar – deri në caktimin e gjyqtarëve në këtë divizion.

2. Gjyqtari Mbikëqyrës i Degës së Gjykatës në Vushtrri është caktuar Gjyqtari Agron Maxhuni, i cili është caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2021.

3. Gjyqtarët e përcaktuar në kuadër të Degës së Gjykatës në Vushtrri, varësisht prej nevojave do të angazhohen edhe në çështjet tjera, në trupe gjykuese, ashtu siç e parasheh të arsyeshme Kryetari i Gjykatës.

NENI 7

ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

1. Në kuadër të Degës së Gjykatës në Skenderaj do të funksionojë Departamenti i Përgjithshëm me divizionin penal, civil dhe divizioni për kundërvajtje me gjyqtarët aktual si në vijim:

1.1 Divizioni Penale;

Gjyqtari Fatos Sejdiqaj

Gjyqtari Valon Hajdini i cili pritet që të filloj në aspektin praktik të trajnimit që nga datë 01.02.2023 pasi që i njëjti është në arsimimin e vazhdueshëm pranë Akademisë së Drejtësisë.

1.2 Udhëheqës i Divizionit Penal do të jetë Gjyqtari Fatos Sejdiqaj

1.3. Divizioni Civil

Gjyqtari Avdullah Mecinaj

Gjyqtari Hajrullah Aruqi

1.4 Udhëheqës i Divizionit Civil do të jetë Gjyqtari Avdullah Mecinaj

1.5 Ashtu edhe siç është përcaktuar në nenin 2 par.2 nën par.2.5 të këtij Plani, në Divizionin për Kundërvajtje janë përcaktuar që Gjyqtarja Nuriye Shala dhe Gjyqtarja Flurije Sylaj t'i kryejnë edhe lëndët e Degës së Gjykatës në Skenderaj me qenë se nuk ka gjyqtar – deri në caktimin e gjyqtarëve në këtë divizion.

2. Gjyqtari Mbikëqyrës i Degës së Gjykatës në Skenderaj është caktuar Gjyqtari Avdullah Mecinaj, i cili është caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2021.

3. Gjyqtarët e përcaktuar në kuadër të Degës së Gjykatës në Skenderaj, varësisht prej nevojave do të angazhohen edhe në çështjet tjera, në trupe gjykuese, ashtu siç e parasheh të arsyeshme Kryetari i Gjykatës.

NENI 8
ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE MITROVICË
- DEGA NË LEPOSAVIQ

1. Në kuadër të Degës së Gjykatës në Leposaviq do të funksionojë Departamenti i Përgjithshëm me divizionin penal, civil dhe divizioni për kundërvajtje.
2. Në bazë të Planit të Përkohshëm të Veprimit i dt.09.11.2022 në kuadër të Divizionit Penal do të jetë Gjyqtari Xhemajl Jusufi.
3. Në bazë të Planit të Përkohshëm të Veprimit i dt.09.11.2022 në kuadër të Divizionit Civil do të jetë Gjyqtari Skender Shala.
4. Ashtu edhe siç është përcaktuar në nenin 2 par.2 nën par.2.5 të këtij Plani, në Divizionin për Kundërvajtje janë përcaktuar që Gjyqtarja Nuriye Shala dhe Gjyqtarja Flurije Sylja t'i kryejnë edhe lëndët e Degës së Gjykatës në Leposaviq me qenë se nuk ka gjyqtar – deri në caktimin e gjyqtarëve në këtë divizion.

NENI 9
ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE MITROVICË - DEGA NË
ZUBIN POTOK

1. Në kuadër të Degës së Gjykatës në Zubin Potok do të funksionojë Departamenti i Përgjithshëm me divizionin penal, civil dhe divizioni për kundërvajtje.
2. Në bazë të Planit të Përkohshëm të Veprimit i dt.09.11.2022 në kuadër të Divizionit Penal do të jetë Gjyqtarja Benita Berisha.
3. Në bazë të Planit të Përkohshëm të Veprimit i dt.09.11.2022 në kuadër të Divizionit Civil do të jetë Gjyqtari Blerim Halimi.
4. Ashtu edhe siç është përcaktuar në nenin 2 par.2 nën par.2.5 të këtij Plani, në Divizionin për Kundërvajtje janë përcaktuar që Gjyqtarja Nuriye Shala dhe Gjyqtarja Flurije Sylja t'i kryejnë edhe lëndët e Degës së Gjykatës në Zubin Potok me qenë se nuk ka gjyqtar – deri në caktimin e gjyqtarëve në këtë divizion.

NENI 10
PËRBËRJA E TRUPEVE GJYKUESE DHE KOLEGJEVE

1. Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore Mitrovicë, si dhe ata të Degëve të Gjykatës në Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq dhe Zubin Potok, do të mund të angazhohen si anëtarë të trupit gjykues në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin për të Mitur të cilët funksionojnë në Gjykatën Themelore Mitrovicë, po ashtu do të mund të caktohen edhe si pjesë e Kolegjeve Penale.
2. Kolegji shqyrtues; Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit dhe kolegjet tjera, do të formohen nga gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentit të Përgjithshëm,

si dhe ai për të mitur, sa herë që ka nevojë për të vendosur për çdo çështje të parashikuar me Kodin e Procedurës Penale.

NENI 11 NDARJA E LËNDËVE

1. Ndarja e lëndëve në punë tek secili gjyqtar bëhet në mënyrë proporcionale përmes programit SMIL.
2. Gjyqtarëve lëndët j'u ndahen me sistemin elektronik SMIL, e sipas nevojës edhe sipas vendimit të Kryetarit të Gjykatës, siç është përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave dhe Rregulloren e përdorimit të programit SMIL.
3. Nëse një gjyqtari të cili i është ndarë lënda për ta gjykuar duhet përjashtuar për arsye të ndryshme ligjore, atëherë kryetari nëse e aprovon përjashtimin, lënda pastaj ndahet sipas SMIL-it, po ashtu edhe sipas Rregulloreve për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.
4. Në procedurën paraprake pranë Departamentit të Përgjithshëm, Departamentit për Krime të Rënda dhe atë për Mitur, ndarja e lëndëve është e caktuar sipas kujdestarisë tek secili gjyqtar në periudha të caktuara kohore sipas marrëveshjeve të gjyqtarëve, po ashtu edhe në Divizionin Kundërvajtës do të jetë sipas kujdestarisë tek secili gjyqtar.
5. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojë Udhëheqësi i Departamentit/Divizionit në bashkëpunim me Administratoren e Gjykatës.

NENI 12 RADHA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE

1. Në parim lëndët zgjidhen sipas radhës së arritjes në Gjykatë. Gjykata në raport me zgjidhjen e lëndëve do të veprojë në bazë të Planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 efikasiteti dhe prioriteti i lëndëve brenda sistemit gjyqësor.
2. Përjashtim nga kjo rregull, bëjnë lëndët me përparësi ligjore të cilat duhet të zgjidhen brenda afateve ligjore ose afateve të arsyeshme, me kusht që edhe ato duhet të vendosen sipas radhës së arritjes në Gjykatë.
3. Obligim për Gjyqtarët në trajtim të lëndëve është caktimi në afatin e caktuar për lëndët të cilat kthehen në rivendosje nga shkalla e dytë, këto lëndë duhet të caktohen në afatin brenda tridhjetë (30) ditëve, për këto lëndë të kthyer në rigjykim si civile dhe penale, Gjyqtarët kanë obligim që së paku çdo tre (3) muaj të raportojnë me raport të veçantë për trajtimin e lëndëve që janë në rigjykim, po ashtu edhe me obligimin që së paku çdo tre (3) muaj të raportojnë për ecurin dhe zgjidhjen e lëndëve që konsiderohen të vjetra dhe që janë pjesë e obligimeve që rrjedhin sipas vendimeve dhe strategjisë së KGJK-së.
4. Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizion Civil përveç lëndëve me prioritet ligjore, të dhunës në familje dhe lëndëve në rigjykim Gjyqtarët duhet të kenë prioritet lëndët e natyrës pronësore për shkak se ka lëndë që palët me vite të tëra nuk kanë marrë përgjigje.

5. Lëndët të cilat janë të shumta kohën e fundit e sidomos ato me padi për paga jubliare dhe pensionale apo tani edhe të rrezikshmërisë në vendin e punës, nuk mund të konsiderohen të natyrës prioritare edhe pse rrjedhin nga marrëdhënja e punës për shkak se janë lëndë që kanë të bëjnë me kompensim të një të drejte që mund dhe kanë obligim organet komunale t'i përmbushin ndaj punëmarrësve të tyre.

6. Divizioni Civil pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë me Degët e saj kanë obligim që për lëndët e natyrës pronësore të raportojnë çdo tre (3) muaj te Kryetari i Gjykatës për numrin e lëndëve të zgjidhura, po ashtu kryetari ka të drejtën që edhe brenda këtij afati të kërkoj raport nga secili gjyqtar përmes mbikëqyrësit për zgjidhjen e lëndëve të caktuara dhe të kryera.

7. Lëndët e natyrës pronësore duhet të caktohen me prioritet pas atyre që kanë prioritet ligjor, duhet të caktohen në afate me të shkurtëra seancat ndërmjet tyre por jo më të gjata se tridhjetë (30) ditë, në mes të seancave gjyqësore, si të seanca pregaditore dhe seanca e shqyrtimit kryesor, me qëllim të ketë efikasitet në trajtim të lëndëve, mos respektimi i afateve të caktuara do të bartë pasojat ligjore ndaj gjyqtarëve në inicim të procedurës.

8. Nëse caktohen lëndë pa rendije sipas kohës së pranimit të lëndëve në gjykata dhe nuk ka arsye apo njoftim paraprak për Kryetarin e Gjykatës kjo është rrethanë për inicim të procedurës.

9. Për lëndë të caktuara e sidomos ato të natyrës civile që kanë të bëjnë me lëndë të shumta ku palë e paditur është një, ndërsa palë paditëse më shumë dhe përfaqësohet nga një i autorizuar, gjyqtarët kanë obligim të zbatojnë bashkimin e lëndëve sipas nenit 408 të LPK-së, respektivisht të procedurës sipas nenit 30 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “1. Kur bashkohen disa lëndë për shqyrtim të përbashkët, lënda në të cilën procedura ka filluar më vonë i bashkohet lëndës procedura e së cilës ka filluar më herët dhe merr numrin e saj. Shkresat e lëndës që janë bashkuar vendosen në një mbështjellës të përbashkët” “2. Për lëndët që përmbushin kushtet ligjore për bashkim, gjyqtari përmes SMIL-it bënë bashkimin e lëndëve” “3. Në ballinën e mbështjellësit të përbashkët të lëndës vendosen numrat dhe shenjat e veçanta të lëndëve të cilat janë bashkuar”.

10. Në Departamentin për Krime të Rënda, lëndëve sipas Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024 do t'ju ipet përparësi e veçantë. Po ashtu sa i përket lëndëve në Departamentin për Krime të Rënda do të veprohet edhe në bazë të pikës 2 të Planit të përkohshëm të veprimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë i dt.09.11.2022.

11. Çdo gjyqtar ka obligim që përveç lëndëve që janë me prioritet në caktim të seancave gjyqësore që janë lëndët me masa, respektivisht nën masën e parabugimit apo arrestit shtëpiak, si dhe lëndë me konfiskim, të caktojnë edhe lëndët e natyrës së keqpërdorimit të detyrës zyrtare, gjyqtarët kanë obligim të raportojnë së paku çdo tre muaj për natyrën e këtyre rasteve, shtyrja e lëndëve të natyrës me prioritet dhe lëndëve të natyrës së keqpërdorimit të detyrës zyrtare të shqyrtohen dhe të mos jetë kohë më e gjatë se tridhjetë (30) ditë në mes të seancave të shqyrtimit gjyqësor, çdo mos trajtim i këtyre lëndëve dhe trajtimi i lëndëve të tjera parqet shkelje dhe mos respektim në zgjidhjen me prioritet të lëndëve, po ashtu paraqet bazë për inicim të procedurës.

12. Gjyqtarët në lëmin penale udhëzohen që me rastin e marrjes së vendimit të referohen tek Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në mënyrë që të kemi një uniformitet në shqiptimin e dënimeve nga Gjykata.

13. Gjykata ka caktuar zyrtarin lidhur me lëndët për të cilat është e mundur që të dërgohen në procedurën e ndërmjetësimit si në lëndët e natyrës civile po ashtu edhe penale pasi që është procedurë alternative e parapare në të dy lëmit. Gjyqtari i çështje në procedurë civile me rastin e pranimit të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të saj duhet që të njoftojë zyrtarin e caktuar nga Gjykata për ndërmjetësim në atë mënyrë që palës paditëse apo palës së paditur t'i dërgohet njoftimi për referimin e rastit për ndërmjetësim. Sa i përket lëndëve të natyrës penale gjyqtari i çështjes në ato raste për të cilat parashihet mundësia që të dërgohen në procedurë të ndërmjetësimit duhet që t'i njoftoj palët në seancë dhe në rast se palët pajtohen për dërgimin e lëndës në procedurë të ndërmjetësimit atëherë të njoftohet zyrtari i Gjykatës i cili është i ngarkuar me këtë detyrë.

NENI 13

PËRPILIMI I AKTGJYKIMEVE, PUBLIKIMI DHE TRANSPARENCA

1. Gjyqtarët në lëndët e natyrës civile kanë obligim ligjor që t'i përmbahen kohës së përpilimit të aktgjyimeve, nga momenti i përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e deri në momentin e përpilimit të aktgjykimit duke j'u përmbajtur udhëzimeve ligjore dhe nuk mund të jetë kohë e përpilimit të aktgjykimit koha e përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, duhet saktë të shënohet koha e përpilimit të aktgjykimit, po ashtu kjo vlen edhe për kohën kur në çështje të procedurës vendoset me aktvendim, përveç nëse kërkohet leje nga Kryetari i Gjykatës për zgjatjen e afatit sipas dispozitave ligjore, mos respektimi pa arsye i afateve paraqet shkelje të dispozitave ligjore e që është bazë për inicim të procedurës.

2. Edhe sa i përket lëndëve të natyrës penale gjyqtarët e kanë obligim ligjor të respektojnë afatet e përpilimit të aktgjyimeve, duke cekur kohën e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me kohën e përpilimit të aktgjyimeve, përveç nëse kanë leje për zgjatjen e afatit ligjor sipas vendimit të Kryetarit të Gjykatës, në të kundërtën mos arsytimi i zgjatjes së afatit paraqet shkelje ligjore, po ashtu edhe sa i përket formës së aktit duhet të respektohen udhëzimet e theksuara sipas Rregullores Nr.02/2020 për Organizmin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës.

3. Si në çështje të natyrës penale po ashtu në çështjet e natyrës civile, gjyqtarët udhëzohen që të zbatojnë format standard në përpilimin e aktgjyimeve dhe vendimeve të tjera gjyqësore, duke pasur parasysh faktin se çdo vendim gjyqësor duhet të përmbajë elementet e kërkuara me ligj.

4. Çdo vendim me të cilin zgjidhet çështja në mënyrë përfundimtare, zyrtarët ligjor apo bashkëpunëtorët e caktuar të cilët punojnë së bashku me gjyqtarët janë të obliguar ta bëjnë përpunimin e vendimit dhe dërgimin e tyre tek zyrtari përkatës për publikimin e tyre brenda afatit dhe rregullave të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ 04/2019 i plotësuar dhe ndryshuar sipas Udhëzimeve Administrative Nr.01.2021 dhe Nr.01/2022.

5. Seancat gjyqësore caktohen nga gjyqtarët e gjykatës në bashkëpunim me stafin profesionale dhe administrative përmes sistemit SMIL dhe orari i seancave gjyqësore duhet të publikohet në uebfaqen e Gjykatës.

NENI 14
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË, VENDOSJA E AKTEVE
GJYQËSORE NË SISTEMIN E EVIDENCËS PENALE

1. Gjykata me qëllim të efikasitetit të punës në çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të veproj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në Gjykatë janë përcaktuar referentët përkatës të cilët e bëjnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Referentët e caktuar në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të raportoj çdo tre (3) për numrin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë po ashtu një (1) herë në fundin e vitit me qëllim të përpilimit të një raporti final lidhur me çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

2. Në përputhje me Rregulloren Nr.11/2022 për evidencën penale të Republikës së Kosovës, në kuadër të Gjykatës është caktuar referenti përkatës për evidencën penale i cili do të veproj në përputhje të plotë me rregulloren e cekur duke kryer detyrat e përcaktuara.

NENI 15
DËRGIMI I LËNDËVE NË GJYKATAT E TJERA SIPAS SHKALLSHMËRISË DHE
ZBATIMI I SISTEMIT SMIL

1. Gjyqtarët në bashkëpunim me stafin mbështetës (zyrtarët ligjore dhe bashkëpunëtorët profesional) janë të obliguar që të kujdesen që lëndët në të cilat është paraqitur ankesa apo mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër vendimeve të Gjykatës, të përcjellen në gjykatën kompetente brenda afateve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi. Sa i përket lëndëve penale në procedurë paraprake të njëjtat do të përcjellën vetëm në mënyrë elektronike përmes sistemit SMIL në gjykatën e shkallës së dytë.

2. Për çdo veprime i cili ndërmerret lidhur me lëndët e caktuar gjyqtarët si dhe zyrtarët e Gjykatës e kanë obligim zbatimin e programit të SMIL-it në regjistrimin e lëndëve, caktimin e seancave, vendimeve procedurale si dhe akteve finale si dhe veprime të tjera që kanë të bëjnë me bartjen e lëndëve dhe ekzekutimin e tyre.

NENI 16
MBLEDHJET E KOLEGJIUMEVE TË GJYQTARËVE DHE STAFIT
ADMINISTRATIV

1. Mbledhjet e kolegjiumeve të gjyqtarëve do të mbahen së paku çdo tre muaj.

2. Në çdo fillim të muajit do të mbahet mbledhje e përbashkët e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Mitrovicë, me gjyqtarët që janë të caktuar që të punojnë në Gjykatën Themelore Mitrovicë po ashtu edhe gjyqtarët të cilët janë të caktuar që të punojnë në Degët e Gjykatës Themelore Mitrovicë. Në këto mbledhje do të paraqiten raportet e punës por do të mund të diskutohet dhe vendoset edhe për çështje të tjera.

3. Kryetari i Gjykatës sa herë që e sheh të nevojshme për të diskutuar dhe vendosur për çështje të caktuara mund të mbajë mbledhje me gjyqtarët.

4. Udhëheqësit e departamenteve/divizioneve së paku çdo tre muaj do mbajnë mbledhje me gjyqtarët e departamentit/divizionit përkatës.

5. Në fund të vitit 2023, do të mbahet Kolegjiumi vjetor i të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Mitrovicë.

NENI 17

ORGANIZIMI I PUNËS SË ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE MITROVICË DHE DEGËT E SAJ

1. Menaxhimi i punëve administrative, teknike dhe të sigurimit të objekteve do të bëhet nga Administratori i Gjykatës Themelore Mitrovicë dhe zëvendësadministratori si dhe nga Ndhmës administratorët e kësaj Gjykate të cilët janë të detyruar që t'i raportojnë Administratorit për punën e tyre, i cili njehërit e mbikëqyr punën e tyre menaxheriale.

2. Administratori dhe Zëvendësadministratori së bashku me ndihmës administratorët së paku çdo tre muaj do të mbajnë takime për të diskutuar dhe vendosur për çështje që ndërlidhen me kompetencat e tyre.

3. Administratori për çdo javë do të mbajë mbledhje me shefat e zyreve për menaxhimin e lëndëve po ashtu me udhëheqësit e zyreve.

4. Të gjithë stafi administrativ i Gjykatës Themelore Mitrovicë, detyrohen që t'i përmbahen orarit të punës dhe gjatë orarit të punës duhet që t'i mbajnë me vete në vende të dukshme dhe t'i kenë gjithmonë kartelat zyrtare të identitetit.

5. Administratori dhe vartësit e tij kanë obligim që të mbikëqyrin, të caktojnë kohën e dhënnjes për pushimet vjetore për stafin siç e përcaktojnë ligjet konkrete për rregullimin e marrëdhënieve të punës varësisht nga pozita e të punësuarit në Gjykatë, pushimi vjetor mund të ndahet në periudha të caktuara, jo më shumë se dy herë brenda një viti, po ashtu të zbatojnë dhe mbikëqyrjen e pushimeve të tjera e sidomos ato mjekësore, në të kundërtën parashihen pasojat ligjore.

6. Nga Zyrtarët e Gjykatës kërkohet që të jenë të arsyshëm për kohën e shfrytëzimit të pushimeve vjetore, e sidomos atyre mjekësore, ofrimi i dëshmime jo të plota bartë pasojat ligjore për atë që i ofron pushim mjekësor, do të mbikëqyret me të drejtën e formimit edhe të komisioneve brenda Gjykatës, që të vlersojnë nevojën e zyrtarit që e shfrytëzon pushimin mjekësor, nëse është duke e shfrytëzuar me arsye, në të kundërtën do të parashihen pasojat në procedurë disiplinore.

7. Kryetari i Gjykatës, Administratorja e Gjykatës po ashtu gjyqtarët do të bëjë vlerësimin vjetor të punës së stafit menaxhues, professional dhe stafit administrative të Gjykatës në përputhje me rregulloret të cilat janë në fuqi. Vlerësimi vjetor i punës bëhet në fundin e vitit sipas kriterëve të përcaktuara por vlerësimi i punës mund të bëhet edhe në periudhë më të hershme kohore në raport me stafin e posa emëruar në pozitë sa i përketë periudhës verifikuese.

NENI 18
NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E PLANIT VJETOR

Ky Plan Vjetor mund të ndryshohet dhe plotësohet nga Kryetari i Gjykatës varësisht nga nevoja për organizimin më të mirë të punëve, zgjedhjen më efektive të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të strukturës së gjyqtarëve. Po ashtu ky Plan Vjetor i Gjykatës mund të ndryshohet dhe plotësohet në raste specifike ku nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, strategjitë e KGJK-së apo Planin e Punës së KGJK-së për vitin 2023.

NENI 19
ZBATIMI I PLANIT

Ky plan i punës do të zbatohet nga data 01.01.2023.


Nënkryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi